

Nr. 17212/2 Prot.

Lezhë, më 26/10 /2022

PROCESVERBAL

I mbajtur me datë 26.10.2022 në orën 17:00 në ambientet e Restorant “Orkidea” në autostradë (në Njësinë Administrative Shënkoll) me prezencën e panelit prej 6 anëtarësh:

1. Kryetarit të Bashkisë Lezhë-Z.Pjerin Ndreu,
2. Zv.Kryetares së Bashkisë Lezhë- Znj.Eueda Molla,
3. Kryetarit të Këshillit Bashkiak Lezhë -Z.Ndue Luli,
4. Administratori i Njësisë Administrative Shënkoll-Z. Ernest Rakaj,
5. Administratori i Njësisë Administrative Zejmen- Gjergj Malshi
6. Administratori i Njësisë Administrative Kolsh-Fatjon Zefi.

si dhe në prezencën e banorëve të njësive administrative Shënkoll, Zejmen dhe Kolsh.

Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë i cili vendosi theksin në temën e takimit duke pritur sygjerime, propozime, ide nga bizneset dhe komunitetet e tre njësive administrative pwr project buxhetin 2023-2025 dhe paketen fiskale 2023. Paraprakisht, ai bëri një parantezë për ecurinë e bashkisë përgjatë këtyre tre viteve të fundit, ato çfarë është bërë, çfarë nuk është bërë dhe arsye pse. Që në fillim të marrjes së detyrës është gjendur përballë një problematike të madhe, borxhit prej 4.6 miliard lekësh. Për shkak të organikës së mbingarkuar, nga të cilët mbi 600 punonjës paguheshin nga të ardhurat e bashkisë, numri i lartë i punonjësve me kontratë, me Vendim të Këshillit Bashkiak është bërë reformë strukturore. 4 % e buxhetit shkonte për investime, pjesa tjetër për paga, sigurime dhe shpenzime operative. Duke ulur numrin e punonjësve, bashkisë do ti kurseheshin bashkisë shumë para të cilat mund të konvertoheshin në investime.

Fokusi i ndërhyrjeve ka qenë në dy shtylla kryesore, turizmi dhe bujqësia. Në lidhje me turizmin promovimi i pasurive dhe vlerave turistike ka qenë në nivele më të larta. Është bërë pastrimi i gjithë territorit, një punë voluminoze për të cilën fillimisht shumë njerëz kanë qenë skeptik. Bregdeti i Tales, Shëngjinit, Rana e Hedhur janë bërë model. Në kuadër të projektit “Praktika të Mira” Bashkia ka fituar me praktikën më të mirë për çështjen e menaxhimit të mbetjeve e cila ka shërbyer si model për bashkitë e tjera pasi kjo praktikë është replikuar prej tyre. Bujqësia është

shtylla tjetër në të cilën janë bërë ndërhyrje madhore, janë menaxhuar dhe pastruar mbi 400 km kanale kulluese duke reduktuar dhe eliminuar problemin e përmytjeve. Gjithashtu janë bërë ndërhyrje edhe në akse të ndryshme rrugore duke bërë asfaltimin e tyre, për shëmbull rruga Grykë Lumi, Qendër Rrilë, Barbullojë etj. Në vijim do të bëhet një kalkulim më i mirë i buxhetit, i cili do të përmirësohet edhe me zerimin e borxhit të bashkisë. Një problem me të cilin jemi ndeshur ka qenë bllokimi i lejeve të ndërtimit. Fokusi do të jetë në realizimin e më shumë ndërhyrjeve në kanalet kulluese, vaditëse, problematikat e ndryshme me të cilat ndeshën fermerët si dhe aspekte të projekteve në infrastrukturë. Infrastruktura në zonat rurale ka marrë një vëmendje të veçantë dhe 60% e buxhetit për infrastrukturën shkon për ndërhyrje në zonat rurale. Shpërndarja është bërë në masë të përafërt për qytetin dhe njësitë administrative. Buxheti do të shkojë në investime për rrugë, ndriçim, trotuare, varrezat dhe ndërhyrje të tjera sipas nevojave dhe kërkesave të komunitetit. Ujësjetësi në Zejmen do të përfundojë së shpejti. Do të ndërhyhet në rrugën Shënkoll Qendër, Rrilë-Hidrovor, Tale 2, etj. me asfaltim, ndriçim, për të qenë gati për sezonin e ardhshëm turistik dhe brenda 2 viteve do të jetë një ndër zonat më turistike dhe të frekuentuara në Shqipëri. Investimet e bashkisë, së bashku me fondet e qeverisë si dhe ekspertizën nga bashkimi evropian do të mundësojnë hartimin dhe implementimin e projekteve madhore. Një ndër këto projekte do të jetë projekti për një sistem energjitik të shkollave, kopshteve me panele diellore, duke shfrytëzuar burimet alternative që disponojmë. Problematikat duhen trajtuar me radhë, pa pasur nevojë të prishim diçka që bëjmë, për të realizuar një tjetër. Niveli i arkëtimit të taksave është i ulët, është në masën 10-15% në tre njësi administrative. Duhet të përvetësohet kultura e pagesës së taksave e cila është një kosto në masë të përballueshme, më pas këto taksa të përkthehen në investime. Tashmë rishikimi i buxhetit do të jetë jo më me tkurrje por me shtim nëpërmjet një marrëveshje më të mirë me komunitetin për pagesën e taksave. Rasti i trotuarit të ndërtuar në Shëngjinin cili u mundësua në bashkëpunim me biznesin i ka shërbyer të gjithë komunitetit duke tërhequr turistë, spostimi nga qendra e qytetit së bashku më ndikimin që ka patur sigurimi i një mjedisi të pastër. Sipas nevojave do të ndërhyhet në qendra shëndetësoret. Disa institucione arsimore janë në kushte shumë të mira, madje janë ndërtuar së fundmi siç është shkolla e mesme e bashkuar Shënkoll, të tjera shkolla kanë nevojë për ndërhyrje. Bazuar në këtë parantezë fjala u kaloi të pranishmëve që të shprehnin sygjërimet e tyre. Në vijim fjalën e mori Z.Gerti Shella i cili prezantoi projektin STAR III si dhe përgëzoi Bashkinë Lezhë për rezultatet e arriturat në kushtet e vështira të shkaktuara si pasojë e termetit,

pandemisë dhe krizës aktuale. Ai theksoi se Bashkia Lezhë ka volumin më të lartë të konsultimeve publike, degjesave me publikun për të njohur nga afër nevojat dhe qëndrimet e banorëve. Modeli i ndërmarrë do të dokumentohet. Mbledhjet e hapura të Këshillit Bashkiak bëjnë që së bashku me banorë, grupe të ndryshme interesi të përcaktojnë prioritetet e vitit të ardhshëm. Kryetari i Bashkisë ja drejtoi fjalën kryepleqve të fshatit.

Ndër ndër problemet e ngritura ishte rruga Rrilë Hidrovor, problemi i varrezave për shkak të pamundësisë së gjetjes së tokës. Kryeplaku i fshatit Shënkoll vendosi theksin tek problemi i ndërgjegjësimit për pagësën e taksave dhe mungesën e ndërgjegjësimit për të kontribuar në komunitet. Në përgjigje të kësaj Kryetari sygjeroi zhvillimin e takimeve lagje me lagje, banor me banor për rritjen e ndërgjegjësimit. Për vitin e ardhshëm do të bëhen ndërhyrje në rrugën e Treshit, Zejmenit, punimet do të bëhen me asfalt, jo me zhavorr për shkak të terrenit dhe mungesës së qëndrueshmërisë. Fjala u drejtua sërish drejt të pranishmëve për pyetje ose sygjerime. Në mungesë të komenteve u bë mbyllja e takimit.

Takimi vijoi më pas me një koktej për të gjithë të pranishmit.

**Drejtori i Drejtorisë së Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diaspores,
Komunikimit dhe Transparencës**

Elson Frroku



Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

Gjystina Nik-ulaj



